Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agim Sheqiri	**17.08.2023**	**22.08.2023**	**2023/0591**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 17.08.2023, OE "PROGLOBAL SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0591, , apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Servisimi, Rimbushja dhe Furnizimi me Aparate kunder zjarrit ne objektet e PK-se" me nr. të prokurimit: "214-23-825-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, per furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 59,884.20 €.

.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit

Neni 28 Specifikimet teknike

Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Te nderuar,

Bazuar ne dispozitat e nenit 108/A, te LPP-se, OE "Proglobal"shpk - Prishtine, e ka kundërshtuar njoftimin e AK - Policia e Kosovës, te datës 01.08.2023, për anulim te aktivitetit te prokurimit: *"**Servisimi, rimbushja dhe furnizimi me aparate kunder zjarrit ne objektet e PK-se**"*, me nr prokurimit: **214-23-825-2-2-1,** konkretisht arsyetimin e eliminimit te kompanisë sonë, ku ne letrën standarde te te njëjtës date ne raport me ofertën tone ka potencuar: *"Oferta e juaj eshtë e pa përgjegjshme sepse pas komunikimeve me prodhuesin dhe sqarimeve me operatorin ekonomik sqarimet te cilat janë ofruar nga ana e OE dhe nga ana e prodhuesit nuk kane qene bindëse për Autoritetin Kontraktues, po ashtu ka pasur ndryshim te deklaratës nga ana e prodhuesit.*

Pretendimet ankimore:

Operatori Ekonomik ankues, "ProGlobal" shpk - Prishtine, sipas kërkesës për ri shqyrtim te datës 04.08.2023, ka kërkuar ri shqyrtim te ofertave meçe ne si operator ekonomik kemi prezantuar te gjitha provat shkresat dhe dëshmitë, përfshi konfirmimet e prodhuesit dhe përshkrimet e detajuara ne katalogë, përmes te cilave konfirmohet se "ProGlobal" shpk, ka dorëzuar oferte te përgjegjshme.

Ne vendimin e Autoriteti Kontraktues- Policia e Kosovës, jepet arsyetim se ne shkresën e datës, 25.07.2022, ne brendësi te tekstit përshkruhet data 04.05.2023 dhe kjo nuk e binde Autoritetin Kontraktues !

Eshtë fakt qe ne brendësi te te njëjtës shkrese përshkruhet data 04.05.2023, pasi qe me ketë date prodhuesi ka ofruar konfirmim për produkte dhe dimensione,

- PROVE1: *Konfirmimi i dates* ***04 Maj 2023***

Fwd: Request for more information

Mauro La Monica -- Emme Antincendio Srl <mauro.lamonica@emme-italia.com> Wed, Jul 26, 2023 at 4:53 PM

To: hazbije krasniqi <hazbije.krasniqi@kosovopolice.com>

We confirm that the product Aluminium Sign of Extinguisher with parameters 150x150 is produced by us.

Cc: "Emme Antincendio Srl, alberto.milli" <alberto.milli@emme-italia.com>, Artan Fejza <artan.fejza@kosovopolice.com

---

Confirmation information

Mauro La Monica -- Emme Antincendio Srl <mauro.lamonica@emme-italia.com> **Thu. May 4, 2023 at 9:00 AM**

To: Latif Imeri <info@proglobal-ks.com>

Cc: "Emme Antincendio Srl, alberto.milli" <alberto.milli@emme-italia.com>

DearLatif,

We confirm that ALUMINUM SIGN OF EXTINGUISHER are in full compliance with the dimensions and materials presented

This is because the ALUMINUM SIGN OF EXTINGUISHER can be made according to the customers order. including materials and dimensions.

In our catalog on the website, not all types and all possible dimensions that we can produce and supply can be included.

Attached is the new catalog with ALUMINUM SIGN OF EXTINGUISHER, including dimensions 150 x 150

ALUMINUM SIGN OF EXTINGUISHER page 3 with Code CAR1001 has dimensions 150 x 150

Kind Regards

Mauro La Monica - Export Sales Account- Tel: +39.340.2849014 - Email: mauro.lamonica@emme-italia.com

Rrjedhimisht ne shkrese gabimisht eshtë pershkruar data e tille dhe ne fakt behet fjale për shkrese te datës 25.07.2023, lëshim teknik ky i konfirmuar dhe i korrigjuar nga prodhuesi.

Komunikimi ne mes Policia e Kosoves dhe prodhuesit EMME Antincendio srl se a prodhohet shenja me dimenzione 150x150, me 21 korrik 2023 pergjigja se nuk disponojne me keto dimenzione, eshte bere nga personi JO i autorizuar i prodhuesit.

Ne si Operator Ekonomik, për hire te korrektësisë, përsëri kemi kërkuar dhe kemi pranuar shkresën - konfirmimin e korrigjuar, me reale. **25.07.2023**, te konfirmuar edhe nga prodhuesi - presidenti i kompanise EMME, qe behet fjalë për lëshim teknik dhe nuk behet fjale për ndryshim material.

- ***PROVE 2:*** *Konfirmimi i datës* ***25.07.2023.***

Prodhuesi, "EMME Anticendio srl"- Itali, prodhon me dhjetëra shenja te ngjashme dhe me dimensione te ndryshme, rrjedhimisht qeshtja e dimensioneve eshtë e realizueshme varësisht nga kërkesa e blerësit dhe për ketë qeshtje AK - Policia e Kosovës, ka zbatuar masat e sigurisë se ekzekutimit.

Pra edhe Autoriteti Kontraktues - Policia e Kosove, sipas vendimit, kundrejt kërkesës për ri shqyrtim e potencon se ka komunikuar me prodhuesin me daten **26.07.2023, ku prodhuesi e KONFIRMON prodhimin e produktit ALUMINIUM SIGN OFEXTINGUISHER me dimensionet, 150 x 150, prandaj për lëshim teknik nuk mund te eliminohet oferta si tërësi.**

- ***PROVE 3:*** *Konfirmimi i datës* ***26.07.2023.***

Neve si Operator Ekonomik, nuk e kemi te qarte insistimin e anulimit te aktivitetit te prokurimit nga AK - Policia e Kosovës, pas hapjes se ofertave dhe me arsyetimin e tille, për kundër konfirmimit dhe sqarimit te produkteve dhe dimensioneve te tyre, përkatësisht oferta jone ne kuptim te paragrafit 2 dhe 4 te nenit 59, te LPP-se, duhet te konsiderohet si e përgjegjshme pasi qe i plotëson te gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftim për kontratë dhe ne dosje te tenderit.

Për me tepër edhe ne katalogun e prezantuar ne oferte janë te përshkruara dimensionet, te cilat AK - Policia e Kosovës, i anashkalon dhe injoron.

Përshkrimi i dimensioneve ne katalogun e ofertës dhe atë te vitit 2023,

Code - Dimensions

CAR1001 150X150 Extinguisher

CAR1002 120X145 Extinguisher

CAR1003 230X310 Extinguisher

PROVE.4. *Katalogu me përshkrim te dimensionit te kontestuar si dhe katalogu i vitit 2023, i prodhuesit EMME.*

Operatori Ekonomik "ProGlobal" shpk, konsideron se insistimi i anulimit te aktivitetit te prokurimit me arsyetimin e potencuar ne letër standarde, bie ndesh me dispozitat e nenit 62, dhe 59, te LPP-se, përkatësisht nenit 38, paragrafi 4, te rregullores nr. 0012/2022, ku përcaktohet:

> "...*Sqarimi dhe kërkesa për informacion shtesë, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit.* ***Kërkesa kalon / nuk kalon dhe vlefshmëria e ofertave/aplikacioneve mund të vendoset vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve në pyetjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë të paraqitura"****.*

Pra për gabim teknik, ligjërisht nuk mund te eliminohet oferta, meçe gabimet teknike janë te korrigjueshme dhe te njëjtat tani me janë korrigjuar, ku ne si OE, kemi prezantuar dëshmi konkrete, rrjedhimisht edhe vet AK - Policia e Kosovës, ka pranuar konfirmim nga prodhuesi,

Prandaj, meçe ekzistojnë prova reale dhe konkrete ne atë mënyre qe Organi Shqyrtues i Prokurimit te nxjerre:

V E N D I M

TE APROVOJ, ne tërësi ankesën tone si te bazuar

TE ANULOJ, njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit dhe

TE URDHEROHET, AK - Policia e Kosovës, qe te kthej lenden ne Rivlerësim dhe oferta jone te trajtohet si oferte e përgjegjshme sipas dëshmive ne oferte dhe kërkesave te dosjes

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(LETRA MBI ELIMINIM)

B42 - Letër standarde për *[tenderuesin] [kandidatin]* e eliminuar [2]

28.07.2023, Prishtine

POLICIA E KOSOVES, Rr "Luan Haradinaj"- nr. 99 ndërtesa e re e Administratës te Policisë, kati II, zyra e Prokurimit nr. 31, Prishtinë, Kosovë

Operatori Ekonomik: PROGLOBAL SH.P.K.

Titulli: Titulli i kontratës: Servisimi, Rimbushja dhe Furnizimi me Aparate kundër zjarrit në objektet e PK-së-rivlerësim

Nr. i prokurimit	214-23-825-2-2-1
Nr i brendshëm	

I/e nderuar(a) *[Z/Znj]/* **PROGLOBAL SH.P.K.**
Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:
Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM
[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzuar] **për këto arsye :**
PROGLOBAL SH.P.K. 811500794
Oferta juaj është e pa përgjegjshëm sepse pas komunikimeve me prodhuesin dhe sqarimeve me Operatorin Ekonomik sqarimet te cilat jane ofruara nga ana e OE dhe nga ana e prodhuesit nuk kanë qene bindëse për Autoritetin Kontraktues , po asht ka pasur edhe ndryshim te deklaratës nga ana e prodhuesit.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.
Me respekt,

HAZBIJE GEASNIQI,
(Zyrtarit i Lart i Prokurimit)

(Nënshkrimi

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **PROGLOBAL SH.P.K.**

Sqarim Hyrës:

AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetim se nuk ka asnjë ofertë të përgjegjshme.

AK ka eliminuar njërin OE për mos vazhdim të validitetit edhe pas kërkesës së AK-së,

Ndërsa OE në këtë rast ankues e ka eliminuar me arsyetim pas komunikimeve me prodhuesin dhe sqarimeve të OE ankues, të njëjtat nuk kanë qenë bindëse për AK.

Pretendimi nr.1

Pretendimi kryesor ankimor ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE nga ana e AK-së.

AK në arsyetim të eliminimit të OE ankues konsataton se për produktin "Aluminium Sign of Extinguisher" OE nuk ka ofruar dimensionet e kërkuara 150x150.

Fillimisht sqarojmë se ky produkt është një shenjë/pllakë e aluminit me simbolin e aparatit të zjarr fikjes, dhe nuk është aparat i zjarrfikës apo pjesë përbërëse e aparatit të zjarr fikjes.

OE ankues ka ofruar sqarime nga prodhuesi se edhe pse ky produkt me këto dimensione nuk gjendet ne katalogun e rregullt te prodhuesit, të njëjtit prodhues kanë ofruar konfirmim se këtë produkt (tabelë/shenjë) e kanë në prodhim dhe të njëjtin do ta ofrojnë në pajtim të plotë me kërkesat e AK-së. Megjithatë këtë sqarim AK e konteston duke thënë se sqarimi është i datës 25.07.2023 ndërsa në brendi ekziston data 04.05.2023.

OE ankues sqaron se data 04.05.2023 mund të jetë lëshim teknik, dhe përveç kësaj përsëri ofron konfirmim nga prodhuesi se tabela/shenja e aluminit me simbol te zjarrfikësit prodhohet dhe do të ofrohet sipas kërkesës së AK-së dhe atë me dimensione 150x150.

Pas gjitha këtyre që u cekën si më lart, vlerësimi ekspertit është se OE ankues ka ofruar prova të mjaftueshme, për të mos thënë të pakontestueshme siç është konfirmimi nga prodhuesi se produkti në fjalë do të ofrohet në pajtim të plotë me kërkesat e AK-së.

E theksojmë edhe një herë se nuk kemi të bëjmë me ndonjë produkt kompleks aparate zjarrfikëse ose pjesët përbërëse të tyre, por kemi të bëjmë me një shenjë/tabele/pllakë te aluminit me simbol të aparatit të zjarr fikjes, për të cilën megjithatë prodhuesi ka dhënë konfirmim se do të ofrohet në pajtueshmëri të plotë me kërkesën e AK.

Bazuar në gjitha këto që u cekën si më lartë vlerësojmë se ankesa e OE ankues është e bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **PROGLOBAL SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Agim Sheqiri